



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E PUNËVE PUBLIKE
DREJTORIA E PROKURIMEVE

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Data: 14/02/2019

Drejtuar: Operatorit Ekonomik “KLAJGER KONSTRUKSION” shpk.
Adresa: Tiranë, Bathore 6-Kamëz, pranë Kopshtit të Fëmijëve Bathore 6

Procedura e prokurimit: **Procedurë e hapur- shërbime**

Numri i referencës së procedurës: **REF-02767-12-29-2018**

Përshkrim i shkurtër i kontratës: **“Blerje shërbimi për mirëmbajtjen e objekteve ndërtimore të Bashkisë Tiranë”**

Fondi limit: 8.489.691 (tetë milion e katërqind e tetëdhjetë e nëntë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e një) lekë pa tvsh.

Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin: **5 (pesë) muaj nga data e nëshkrimit të kontratës.**

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: **24/01/2019, Ora: 12:00**

Publikime të mëparshme: **Buletini i Njoftimeve Publike, Numër 1, Datë 07.01.2019.**

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: **çmimi më i ulët X oferta ekonomikisht më e favorshme**

Njoftojme se, kane qenë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. **“Viante Konstruksion” sh.p.k** **NIPT-i K47103804L**

Vlera totale e ofertës: 7.125.816.72 (shtatë milion e njëqind e njëzetë e pesë mijë e tetëqind e gjashtëmbëdhjetë, pikë shtatëdhjetë e dy) lekë pa TVSH.

2. **“Klajger Konstruksion” sh.p.k** **NIPT-i K51423028P**

Vlera totale e ofertës: 7.451.640 (shtatë milion e katërqind e pesëdhjetë e një mijë e gjashtëqind e dyzetë) lekë pa TVSH.

3. **Bashkimi i Operatorëve ekonomik “Flondi Konstruksion” sh.p.k & “ED Konstruksion” sh.p.k** **NIPT-i J74818819M**

Vlera totale e ofertës: 8,049,343 (tetë milion e dyzetë e nëntë mijë e treqind e dyzetë e tre) lekë pa TVSH.

4. Operatori ekonomik "ELDA-VL" sh.p.k

NIPT-i K67106202W

Vlera totale e ofertës: 0 (zero) lekë.

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori Ekonomik "Viante Konstruksion" shpk NIPT-i K47103804L

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të Nenit 53 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, "Për Prokurimin Publik", (i ndryshuar), dhe të Kreut VII Nenit 66 pikës 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për Miratimin e rregullave të prokurimit publik", (i ndryshuar), si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e dokumentacionit të paraqitur nga ky Operator ekonomik, nga ku rezultoi se:

1.1 Operatori ekonomik "Viante Konstruksion" shpk për plotësimin e Pika 2, "Kriteret e Veçanta të Kualifikimit/ Kapaciteti teknik:

Pika 5 "Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë në stafin e tyre dhe të figurojnë si drejtues teknik në licencën e shoqërisë si dhe në listpagesat e shoqërisë për gjashtë muajt e fundit:

1 (një) Inxhinier Ndërtimi

1 (një) Inxhinier Elektrik

1 (nje) inxhinier Mjedisi

1.1.1 Operatori Ekonomik "Viante KONSTRUKSION" shpk ka paraqitur dokumentacionin e mesiperm per 1 (nje) inxhinjere mjedisi, por nga verifikimi i list pagesave, konstatohet se inxhinjeria e mjedisit Artenisa Bakiu eshte paraqitur me 0 dite pune, gjithashtu duke ju referuar numrit te kategorie se punonjesit per kontribute 2.031 i cili shpjegon se "I punësuar, i cili për gjithë muajin ka qënë me raport leje barrëindje ose raport mjekësor pas ditës së 14 dhe merr përfitime nga skema e sigurimeve shoqërore, por nuk i ka shkëputur (zgjidhur) marrëdhëniet e punës me subjektin përkatës, deklarimi për këta persona nga subjekti ku ata janë të regjistruar".

Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi.

Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, makineritë, pajisjet, përvojën e duhur, **personelin** dhe kapacitetet e duhura ekonomike e financiare, **për të zbatuar kontratën** objekt prokurimi dhe janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion. Operatori ekonomik duhej të dorëzonte në sistemin e prokurimeve elektronike të gjithë dokumentacionin e ofertës në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit nga autoriteti kontraktor si edhe në përputhje dhe sipas udhëzimeve të Agjencisë së Prokurimit Publik për mënyrën e hedhjes së dokumentacionit në sistemin e prokurimeve elektronike.

Rrjedhimisht, dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik "Viante KONSTRUKSION" shpk per 1 (nje) inxhinier Mjedisi **nuk mund te konsiderohet i vlefshem.**

1.2 Pika 7 "Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës...":

1.2.1 Autoriteti Kontraktor ka kërkuar ti vihet në dispozicion 500 m² skela+ rrjete mbrojtese për ekzekutimin e kontratës. Operatori Ekonomik në përmbushje të kriterit të mësipërm të kërkuar nga AK në dokumentat standarte te tenderit ka paraqitur vetem skela, por mungon

rrjeta mbrojtese, për rrjedhojë i pavlefshëm. Skela dhe rrjete mbrojtese 25350 kg kontrate qeraje me “Beladi” sh.p.k do **konsiderohet e parregullt pasi mungoj rrjeta mbrojtese.**

1.2.2 Autoriteti Kontraktor ka kërkuar ti vihet në dispozicion 1 eskavator me goma për ekzekutimin e kontratës. Operatori Ekonomik në përmbushje të kriterit të mësipërm të kërkuar nga AK në dokumentat standarte të tenderit ka paraqitur një Eskavator me goma me targe ABMT90 nr shasie 970628 i deklaruar nga kontrata e qeraje me “AURORA KONSTRUKSION” sh.p.k., për të cilin nga verifikimi i dokumentacionit rezultoi se i kanë mbaruar afati i siguracionit dhe kolaudimit perkatesisht ne datat 14.01.2019 dhe 16.01.2019 për këto arsye **konsiderohet i parregullt.**

Pra sa më sipër cituar, dokumentacioni i paraqitur nga Operatori Ekonomik lidhur me plotësimin e kriterit, është i paplotë lidhur me skelat + rrjete mbrojtese 500m² dhe eskavator me goma 1 cope, **për rrjedhojë i pavlefshëm.**

Kriteret kualifikuese të përcaktuara nga autoriteti kontraktor janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga të gjithë ofertuesit ekonomikë pjesëmarrës në një procedurë prokurimi.

Operatorët ekonomikë pjesëmarrës duhet të vërtetojnë se zotërojnë reputacionin, besueshmërinë, **makineritë, pajisjet**, përvojën e duhur, personelin dhe kapacitetet e duhura ekonomike e financiare, për të zbatuar kontratën objekt prokurimi dhe janë të detyruar të përgatisin oferta, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, në mënyrë që edhe vlerësimi të bëhet në përputhje me këtë dokumentacion. Operatori ekonomik duhet të dorëzonte në sistemin e prokurimeve elektronike të gjithë dokumentacionin e ofertës në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit nga autoriteti kontraktor si edhe në përputhje dhe sipas udhëzimeve të Agjencisë së Prokurimit Publik për mënyrën e hedhjes së dokumentacionit në sistemin e prokurimeve elektronike.

Rrjedhimisht, dokumentacioni i paraqitur nga operatori ekonomik për një mjet dhe një pajisje nuk mund të konsiderohet i vlefshëm.

Për sa më sipër, Operatori ekonomik “**Viante Konstruksion**” shpk, **nuk plotëson** “Kriteret e veçanta të kualifikimit/ Kapaciteti teknik.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të Nenit 53 pika 5, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin publik” (i ndryshuar) dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu VII, Neni 66 pika 3, **e shpalli të pavlefshme** këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

2. Operatori Ekonomik “ELDA-VL” shpk

NIPT-i K67106202W

Përkatesisht për arsyet e mëposhtme:

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave në mbështetje të Nenit 53 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për Prokurimin Publik”, (i ndryshuar), dhe të Kreut VII Neni 66 pikës 3 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar si dhe dokumentave të tenderit të miratuara, vijoi me shqyrtimin dhe vlerësimin e ofertës së paraqitur nga Operatori Ekonomik “ELDA-VL” shpk, nga ku rezultoi se:

Operatori ekonomik “ELDA-VL” shpk **nuk ka paraqitur asnjë ofertë ekonomike** si edhe nuk i ka plotësuar kriteret e përgjithshme të pranimit/kualifikimit, kriteret e veçanta të kualifikimit, kapacitetin ekonomik dhe financiar si edhe kapacitetin teknik të kërkuar për këtë procedurë. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave e shpall **të pavlefshme këtë ofertë.**

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik **“KLAJGER KONSTRUKSION” shpk**, me adresë: Tiranë, Bathore 6- Kamëz, pranë Kopshtit të Fëmijëve Bathore 6, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 7.451.640 (shtatë milion e katërqind e pesëdhjetë e një mijë e gjashtëqind e dyzetë) lekë pa TVSH është **identifikuar si oferta e suksesshme**.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Drejtorisë së Prokurimeve, Bashkia e Tiranës, Sheshi Skënderbej, Nd. 2, Kodi postar 1001, Tirane, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 60 (gjashtëdhjetë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t'i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej *[nuk plotësohet kufiri i lejuar sipas ligjit për diferencën e vlerës]*, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në **datë 14.02.2019**

Ankesa: Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Nenit 63 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, **nuk është paraqitur asnjë ankesë.**